

Kujtesa të rëndësishme rreth përzgjedhjes dhe vendosjes në programin ELL


- ◆ Nxënësi ELL mund të vendoset në Programin e Edukimit Dytijohësor Kalimtar (TBE), në Programin Dytijohësor ose në Anglishten e Pavarur si një Gjuhë e Dytë (ESL) brenda dhjetë ditëve të regjistrimit.
- ◆ Studimet tregojnë se nxënësit që qëndrojnë në një program vazhdimisht, e fitojnë përvetësimin e anglishtes më shpejt dhe kanë rezultate më të mira në mësim në krahasim me nxënësit që shkojnë nga një program në tjetrin.
- ◆ Nëse programi TBE që keni zgjedhur nuk është në dispozicion në shkollën e fëmijës suaj, mund të kërkonte të transferoheni në një shkollë tjetër, në atë distrikt ku është në dispozicion programi TBE. Të gjithë nxënësit ELL duhet të marrin pjesë në të paktën një program ESL.
- ◆ Nëse nuk e keni plotësuar Pyetësorin për Prindërit dhe Formularin e Përzgjedhjes së Programit, shkolla do ta vendosë fëmijën tuaj automatikisht në një program TBE nëse është në dispozicion. Përndryshe fëmija do të vendoset në një program ESL.
- ◆ Kur fëmija juaj e tejkalon nivelin e caktuar të shtetit në zotërimin e gjuhës në provimin e arritjeve në gjuhën angleze si gjuhë e dytë të shtetit të Nju Jorkut (NYSESLAT), atëherë ai ose ajo mund të futet në programin e mësimdhënies vetëm në anglisht. Fëmija juaj mund të vazhdojë të marrë ndihmë dygjuhësore ose ESL.
- ◆ Ju do të njoftoheni nëse fëmija juaj vazhdon t'i plotësojë kushtet për të marrë shërbime ndihme, bazuar në nivelin e fëmijës suaj për zotërimin e anglishtes (siç përcaktohet nga nota e tij ose e saj në NYSESLAT) para fillimit të çdo viti të ri shkollor.
- ◆ Shërbimet për nxënësit ELL që gjithashtu marrin shërbime të Arsimit të Veçantë sigurohen në përputhje me Planet Individuale të Arsimit (Individual Education Plans, IEP) të nxënësit.

Mund të merrni pjesë në arsimimin e fëmijës suaj në rrugët e mëposhtme:

- ◆ Sigurohuni që fëmija juaj vjen në shkollë çdo ditë, i gatshëm për të mësuar.
- ◆ Sigurohuni që fëmija juaj lexon, punon në lëndët shkollore dhe i bën detyrat e shtëpisë çdo ditë.
- ◆ Merrni pjesë në aktivitete shkollore, të tilla si ekskursionet të klasës, mbledhje dhe në mbledhjet e Shoqatës së Prindërve dhe Mësuesve (Parent Teacher Association, PTA) / dhe të Shoqatës së Prindërve (Parent Association, PA).
- ◆ Merrni pjesë në konferencat e prindërve dhe mësuesve.
- ◆ Merrni pjesë në seminarët dhe konferencat që janë përcaktuar veçanërisht për t'ju asistuar juve për të ndihmuar fëmijën tuaj.
- ◆ Ndihmoni fëmijën tuaj të marrë një librezë anëtarësie në bibliotekën publike dhe vizitoni bibliotekën vazhdimisht.
- ◆ Shërbeni si prind vullnetar në shkollën e fëmijës suaj.
- ◆ Krijoni një mjedis përkrahës në shtëpi për të mësuar dhe studiuar.
- ◆ Lexoni me fëmijën tuaj në gjuhën tuaj amtare çdo ditë dhe nxiteni atë të lexojë 30 minuta çdo ditë.

Për informacion shtesë, mund të

- ◆ Flisni me mësuesin e fëmijës suaj, drejtorin e shkollës ose koordinatorin e prindërve të shkollës.
- ◆ Vizitoni ndonjë nga Qendrat Rajonale të Ndhmës për të Mësuarit (Regional Learning Support Centers). Pyesni koordinatorin e prindërve për adresën dhe numrin e telefonit të qendrës pranë jush.
- ◆ Telefononi 311 për të gjetur adresën e zyrës lokale rajonale ose atë të distriktit dhe vizitoni ato.
- ◆ Telefononi zyrën e nxënësve ELL në numrin (212) 374-6072.
- ◆ Vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Arsimit: www.nycenet.edu.



Qyteti i Nju Jorkut Departamenti i Arsimit

Joel I. Klein
Kancelar


Carmen Fariña
Zëvendës Kancelare
për mësimdhënien dhe mësimarrjen


Maria Santos
Shefe e Lartë e anës Mësimore
Zyra e Nxënësve që Mësojnë Gjuhën Angleze

Departamenti i Arsimit i Nju Jork Sitit

Zyra e Nxënësve që Mësojnë Gjuhën Angleze

*Udhëzues për prindërit e
nxënësve që mësojnë
gjuhën angleze*





— vizatimi nga artisti i klasës së gjashtë Jeormen Carr (PS 137, Rajoni 5) dhe fitues i konkursit të logos së ELL-së "Urat drejt përsosmërisë" ("Bridges to Excellence")

Misioni ynë:

Zyra e Nxënësve që Mësojnë Gjuhën Angleze (English Language Learners, ELLs) u siguron nxënësve ELL dhe familjeve të tyre barazi dhe mundësi përdorimi të edukimit të përsosur me anë të fuqizimit të personelit të mësimdhënies, të nxitjes së përfshirjes së prindërve dhe të përmirësimit të ndihmës me materiale. Zyra përpaket që të krijojë një ambient rigoroz mësimi që përqëndrohet në arritjet mësimore, në zhvillimin e gjuhës dhe zhvillimin social dhe në përkrahjen e dy ose më shumë kulturave.

I dashur prind ose kujdestar:

Zyra e Nxënësve që Mësojnë Gjuhën Angleze në Departamentin e Arsimit në Nju Jork Siti (New York City Department of Education) dëshiron që fëmija juaj të ketë sukses në mësim. Kjo është arsyeja që jemi të gëzuar t'i ndajmë me ju programet që janë në dispozicion për nxënësit e rinj, gjuha amtare e të cilëve nuk është anglisht dhe që mund të kenë nevojë për të zotëruar anglishten në shkollat tona. Ne i quajmë këta Nxënës që Mësojnë Gjuhën Angleze, ose ELL.

Programet për nxënësit ELL në Nju Jork Siti bëjnë shumë më tepër se përmirësojnë zhvillimin e tyre të gjuhës angleze. Me më shumë se 143.000 nxënës të regjistruar tani në shkollat tona, të cilët përfaqësojnë 160 gjuhë të ndryshme, programet tona bëjnë shumë më tepër se mësimin e gjuhës për të ndihmuar nxënësit t'i rrisin në maksimum talentet e tyre të ndryshme dhe aftësitë në leximin e shkrimit dhe gjuhës së tyre amtare, si dhe lëndëve shkollore, të tilla si shkencat dhe matematika. Në mënyrë që nxënësit ELL të shquhen nga ana mësimore në shkollat tona, ata duhet të arrijnë të njëjtat standarde rigorozë arsimimi në shkollë shteti dhe qyteti për klasën e tyre, të njëjta me nxënësit që e zotërojnë mirë anglishten. Kjo kërkon më shumë se vetëm ndihmë për të mësuar gjuhën angleze.

Në Nju Jork Siti, ne sigurojmë programe dygjuhësore, (Edukimit Gjuhësor Kalimtar – "Transitional Bilingual Education" dhe Programi Dygjuhësor - "Dual Language") që forcojnë zhvillimin e gjuhës amtare të nxënësve dhe zotërimin e lëndëve shkollore gjatë periudhës kalimtare në anglisht. Ne gjithashtu sigurojmë programe të Anglishtes si Gjuhë e Dytë (English as a Second Language, ESL) që përdorin strategji për të ndihmuar nxënësit të kenë akses në zhvillimin e gjuhës së re dhe të lëndëve mësimore nëpërmjet anglishtes. Të gjitha programet u sigurojnë nxënësve ndihmë ESL, të përshtatur për nivelin e tyre të zotërimit të anglishtes.

Si prind, ju luani një rol kryesor për të përcaktuar programin që i përshtatet më mirë nevojave mësimore dhe kulturore të fëmijës suaj. Ne presim me kënaqësi që të punojmë me ju për të marrë këto vendime dhe e vlerësojmë pjesëmarrjen tuaj në arsimimin e fëmijës suaj. Ndhuni të lirshëm të pyesni koordinatoret e prindërve dhe anëtarët e personelit në shkollën e fëmijës suaj rreth programeve ELL, ose të përdorni informacionin e kontaktit në këtë broshurë. Ju urojmë juve dhe fëmijës suaj një vit të lumtur dhe frutdhënës.

Sinqerisht,

Zyra e nxënësve të ELL

Pyetje të bëra shpesh rreth nxënësve ELL

Si e përcakton shkolla nëse fëmija im është një nxënës që mëson gjuhën angleze?

Të gjithë prindërve ose kujdestarëve të nxënësve të rinj u kërkohet që të plotësojnë Pyetësorin e Identifikimit të Gjuhës që Flitet në Shtëpi (Home Language Identification Survey, HLIS). Ky pyetësor i bën të ditur personelit të shkollës se çfarë gjuhe flisni në shtëpi. Nëse pyetësori HLIS tregon se fëmija juaj përdor një gjuhë të ndryshme nga anglishtja, ai ose ajo do të japë provimin e rishikuar të vlerësimit të nivelit të gjuhës me anën e krahasimit të grupeve të ngjashme (Language Assessment Battery-Revised, LAB-R). Rezultati në këtë provim përcakton nëse fëmija juaj i plotëson kushtet për shërbimet e ndihmës së zhvillimit të gjuhës angleze. (Nëse rezultatet e provimit LAB-R tregojnë se fëmija është nxënës ELL dhe në shtëpi flitet spanjisht, ai ose ajo gjithashtu duhet të bëjë provimin LAB në spanjisht për të përcaktuar se cila gjuhë flitet më mirë).

Kush do të më njoftojë nëse fëmija im i plotëson kushtet për shërbimet e ndihmës së zhvillimit të gjuhës angleze?

Shkollat kanë përgjegjësinë për të identifikuar, njoftuar dhe për të vendosur nxënësit në programet e mësimdhënies së ELL-së.

Mbasi të njoftohem për gjendjen e fëmijës sim, si mund të marr më shumë informacion rreth programeve dhe shërbimeve ELL?

Shkollave u kërkohet që të kenë mbledhje orientimi për prindërit ose kujdestarët e nxënësve të rinj ELL që mësojnë gjuhën angleze, për t'i informuar ata për programet e ndryshme ELL që janë në dispozicion. Në këto orientime, ju keni mundësinë për të marrë materiale rreth programeve ELL në gjuhën që flisni në shtëpi, si dhe për të bërë pyetje rreth shërbimeve ELL (me ndihmën e një përkthyesi, kur të jetë e mundur). Në fund të çdo orientimi, personeli shkollor mbledh Pyetësorët për Prindërit dhe Formularin e Përzgjedhjes së Programit, i cili tregon programin që kërkoni për fëmijën tuaj.

Çfarë programesh ELL janë në dispozicion për fëmijën tim?

- ◆ **Programet e Edukimit Dygjuhësor Kalimtar** (Transitional Bilingual Education, TBE) përfshijnë mësimdhënien e arteve të gjuhës dhe të lëndëve të ndryshme në gjuhën amtare të nxënësit dhe në anglisht, si dhe mësimdhënie intensive në anglisht si një gjuhë e dytë. Kur nxënësi e zotëron më mirë anglishten duke përdorur njohuritë e forta dhe aftësitë mësimore të siguruara në gjuhën amtare, mësimdhënia në anglisht rritet dhe mësimdhënia në gjuhën amtare zvogëlohet.
- ◆ **Programet Dygjuhësore** (Dual Language) sigurojnë gjysmën e mësimdhënies në anglisht dhe gjysmën në gjuhën amtare të nxënësve ELL në program (p.sh. spanjisht, kinezçe, haiti-kreole). Nxënësit e gjuhës amtare mësohen pranë nxënësve që flasin anglisht, në mënyrë që të gjithë nxënësit të edukohen në dy kultura dhe të flasin rrjedhshëm në të dyja gjuhët.
- ◆ **Programet e "Anglishtes së Pavarur si një Gjuhë e Dytë"** (Freestanding English as a Second Language program, ESL) sigurojnë të gjithë mësimdhënien e arteve të gjuhës dhe të lëndëve të ndryshme në anglisht, nëpërmjet përdorimit të metodave të veçanta të mësimdhënies. Mund të ketë në dispozicion ndihmë në gjuhën amtare.

Kur mund të dalë fëmija im nga programet ELL dhe do të kalojë në klasat ku mësimdhënia jepet vetëm në anglisht?

Kur fëmija juaj të arrijë një nivel të caktuar të zotërimit të gjuhës angleze në provimin e arritjeve në gjuhën angleze si gjuhë e dytë të shtetit të Nju Jorkut (New York State English as a Second Language Achievement Test, NYSESLAT), atëherë ai ose ajo mund të futet në programin e mësimdhënies vetëm në anglisht. (Rekomandohet që nxënësit e programit Dygjuhësor të qëndrojnë në program gjatë gjithë periudhës). Nëse fëmija juaj kalon në klasat që jepen vetëm në anglisht, mbasi ta ketë zotëruar anglishten mirë, ai ose ajo mund të marrë ndihmë dygjuhësore ose ESL sipas nevojës.